A2 _ SPECIFIKIME TEKNIKE (ANEKS III)

Titulli i kontratës:	Prodhimi i një linje përpunimi për mbetjet organike të kërmillit dhe bimëve medicinale
Referenca e kontratës:	A08-1

1. Qëllimi i prokurimit

Autoriteti kontraktor synon të prokurojë artikullin e mëposhtëm, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara më poshtë.

2. Specifikimet teknike:

(1) Prodhimi i një linjë përpunimi për mbetjet organike të kërmillit dhe bimëve medicinale - 1 copë, me këto specifikime:

Seksioni A – Grirësi (shredder)

A1 – Kazan inoksi me shrek me dhëmbë dhe me dy disqe prerëse:

1. Konstruksioni i kazanit – inoks
2. Përmasa e kazanit – gjatësi 60 cm x gjëtësi 40 cm
3. Shrek me dhëmbë - 60 × 25 cm
4. Disku i parë prerës - me përmasa 18 cm, me dhëmbë prerës 1 cm
5. Disku i dytë prerës - me përmasa 24 cm, me dhëmbë prerës 1 cm

A1 – Grirës i dyfishtë (double shredder):

1. Dy rula me rrotullim të kundërt – me afërisht 35 cm gjatësi
2. Ruli i parë: me 18 disqe rrotulluese, afersisht 370 dhëmbë, trashësi 8 cm
3. Ruli i dytë: me 19 disqe rrotulluese, afersisht 370 dhëmbë, trashësi 8 cm
4. Reduktor
5. Elektromotor trefazor 4-5 kW

A2 – Grirës i njëfishtë (single shredder):

1. Një disk prerës monobllok
2. Elektromotor monofazë 0.5-0.7 kW
3. Një levë me kundra dhe oshë shtrënguese
4. Transportier duhet te furnizohet ne dy menyra te pavaruara: me matreial te perzgjedhur me permase < 0.9 cm dhe me furnizim me vete per matrial me permasa > se 0.9 cm

Seksioni B – Transportier me shkallë:

1. Përmasa: 300 × 90 x 30 cm
2. Rrip plastik
3. Konstruksion inoks 304
4. Moto-reduktor trefazor 0.5-1 kW

Seksioni C – Seleksionues/kalibrues cilindrik:

1. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 2.5 mm, vrima me përmasa 1 mm
2. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima me përmasa 1 mm
3. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima me përmasa 4 mm
4. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima drejtkendëshe me përmasa 2 × 8 mm
5. Cilindër, perimeter 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima drejtkëndeshe me përmasa 4 × 8 mm
6. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima me përmasa 8 mm
7. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima me përmasa 10 mm
8. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1.5 mm, vrima me përmasa 12 mm
9. Cilindër, perimetër 2.5 m, trashësi 1 mm, vrima me përmasa 24,5 mm
10. Bazament cilindri, trashësi 14 mm, inoks 304

11. Krehër perzierës (mixing comb) me rrutullim të kundërt me cilindrin, hapesirë 10 mm, me dhëmbë 10 mm, inoks
12. Bosht inoksi me kundër-rrotullim
13. Moto-reduktor trefazor 0.7-1.5 kW

(2) Transportimi i furnizimeve (pajisjeve) nga magazina e furnizuesit/prodhuesit deri në vendin e dorëzimit, përfshirë **shkarkimin** në destinacionin përfundimtar

(3) Instalimi dhe demonstrimi fillestar i përdorimit të pajisjeve për stafin e përcaktuar të autoritetit kontraktor.

Furnizimet e ofruara duhet të jenë të reja dhe të papërdorura, të jenë të plota dhe të gatshme për përdorim pas dorëzimit, dhe të përputhen me kërkesat teknike.

3. Afati i dorëzimit dhe periudha e garancisë

***Lloji i dorëzimit*:** Furnizimet duhet të dorëzohen me detyrime të paguara (DDP[1]), në vendndodhjen e specifikuar më poshtë.

***Vendi i dorëzimit*:** Ekoprod, Proger-Mancurisht Lagjja Periferike, Rruga e Hyrjes ne Fshat, Km I, ZK.2589, Korcë.

***Afati i dorëzimit*:** maksimumi **45 ditë** kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

***Periudha minimale e garancisë*: 12 muaj** nga pranimi provizor.

4. Kushtet e pjesëmarrjes

Për këtë procedurë tenderimi, pjesëmarrja është e hapur për të gjithë personat fizikë dhe juridikë (që marrin pjesë individualisht ose në grupim/konsorcium kandidatësh/ofertuesish), të cilët janë të regjistruaR të cilët janë të regjistruar sipas ligjit në Shqipëri.

5. Tenderuesi duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

1 - Oferta teknike:

- Një përshkrim të detajuar të furnizimeve të ofruara, në përputhje me specifikimet teknike, së bashku me çdo dokumentacion mbështetës të kërkuar sipas dosjes së tenderit. Oferta teknike duhet të paraqitet duke përdorur modelin përkatës (*B2 - Oferta Teknike*). Fletë shtesë mund të shtohen kur është e nevojshme.

2 - Oferta financiare:

- Një ofertë financiare për furnizimet e ofertuara, duke përfshirë, sipas rastit, çmimin e çdo shërbimi ndihmës. Kjo ofertë financiare duhet të paraqitet duke përdorur modelin përkatës (*B3 - Oferta Financiare*). Fletë shtesë mund të shtohen kur është e nevojshme.

3 - Dokumentacioni:

- "Formulari i Dorëzimit të Ofertës", duke përfshirë "Deklaratën dhe deklarimin mbi nderin të ofertuesit", të plotësuar dhe nënshkruar siç duhet. Në rastin e një konsorciumi, formulari duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i konsorciumit i autorizuar në mënyrën e duhur, me autorizimin përkatës të bashkëlidhur. Ku dokument të paraqitet duke përdorur modelin përkatës (*B1 - Formular i Dorëzimit të Ofertës*).
- Dokumenta (*si për shembull: kontrata, letra reference, etj.*) që vërtetojnë të paktën 2 (dy) eksperienca të mëparshme gjatë 3 (tre) vitet e fundit në prodhimin e pajisjeve të ngjashme.
- Dokumenti(et) e regjistrimit të entitetit (ekstrakt nga regjistri tregtar) të ofertuesit dhe, sipas rastit, të secilit anëtar të konsorciumit. Ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të tenderit.

[1] DDP (Delivered Duty Paid) / DAP (Delivered At Place) — Incoterms 2020 International Chamber of Commerce http://www.iccwbo.org/incoterms/

6. Dorëzimi i ofertave

Afati i fundit i pranimit te tenderëve/ofertave është: **30 Qershor 2026, ora 23:00**

Ofertat duhet të përgatiten në ***Anglisht ose Shqip*** dhe të ***dorëzohen me e-mail*** në të ***dy adresat*** mëposhtë:

tendersekoprod@enterimpact.com dhe info@ekoprod.al

Oferta duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për t'u mundësuar vlerësuesve një krahasim të lehtë ndërmjet specifikimeve të kërkuara dhe specifikimeve të ofruara. Dokumentacioni eventual i paraqitur duhet të tregojë qartë (me theksim ose shenjim) modelet e ofruara dhe opsionet e përfshira, nëse ka, në mënyrë që vlerësuesit të mund të shohin konfigurimin e saktë. Ofertat që nuk lejojnë identifikimin e saktë të modeleve dhe specifikimeve mund të refuzohen nga komiteti i vlerësimit

7. Vlerësimi i ofertave

Do të përzgjidhet **çmimi më i ulët** ndër ofertat e përputhshme që plotësojnë specifikimet teknike

8. Njoftimi për dhënien e kontratës

Ofertuesi fitues do të njoftohet me email se oferta e tij është përzgjedhur.

9. Nënshkrimi i kontratës

Përpara nënshkrimit të kontratës, ofertuesi fitues duhet, nëse kërkohet, të paraqesë provat dokumentare ose deklaratat e kërkuara nga autoriteti kontraktor brenda afatit të përcaktuar. Pas marrjes së kontratës së nënshkruar nga autoriteti kontraktor, ofertuesi fitues duhet ta nënshkruajë, datojë dhe kthejë atë te autoriteti kontraktor brenda afatit të përcaktuar. Mosdorëzimi i provave të kërkuara ose mosnënshkrimi dhe moskthimi i kontratës brenda afateve të zbatueshme mund të çojë në anulimin e dhënies së kontratës dhe kalimin e saj te ofertuesi tjetër me çmimin më të ulët që është në përputhje, ose në anulimin e procedurës.

10. Anulimi i procedurës së tenderit

Autoriteti kontraktor mund ta anulojë procedurën e tenderit në çdo fazë, veçanërisht kur nuk merret asnjë ofertë e përshtatshme, kur kushtet financiare ose teknike të projektit kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore, kur zbatimi bëhet i pamundur, ose kur shkelje të detyrimeve, parregullsi apo mashtrim ndikojnë në drejtësinë ose vlefshmërinë e procedurës. Autoriteti kontraktor nuk mban përgjegjësi për asnjë dëm që rrjedh nga një anulim i tillë.

11. Konfidencialiteti

E gjithë procedura e vlerësimit është konfidenciale, në përputhje me procedurat e Autoritetit Kontraktor për qasjen në dokumente. Vendimet e Komitetit të Vlerësimit janë kolegjiale dhe shqyrtimi i tyre zhvillohet me dyer të mbyllura. Anëtarët e Komitetit të Vlerësimit janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë. Raportet e vlerësimit dhe procesverbalet e mbajtura janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'u komunikohen ofertuesve ose ndonjë pale tjetër, përveç Autoritetit Kontraktor, Donatorit, autoriteteve ligjore dhe tatimore, sipas kërkesës së tyre.

12. Klauzolat etike dhe kodi i sjelljes

Ofertuesit duhet të respektojnë kërkesat etike të përcaktuara në dosjen e tenderit, duke përfshirë rregullat për konfliktin e interesit, të drejtat e njeriut, standardet mjedisore dhe të punës, luftën kundër korrupsionit, ndalimin e ryshfetit dhe shpenzimet e pazakonta tregtare. Çdo shkelje, parregullsi ose mashtrim mund të çojë në refuzimin e ofertës, anulimin e procedurës ose masa të tjera të zbatueshme.